

Libri “Drama e jetës”: Një dëshmi për lirinë, dinjitetin dhe kujtesën

nga Dr. Brunilda Çërraga

Klubi i librit: “Drama e jetës” zhvillohet në kuadër të përkujtimit të Revoltës së Spaçit, një prej ngjarjeve më domethënëse të historisë së qëndresës kundër diktaturës komuniste në Shqipëri.

Çdo përvjetor i Revoltës së Spaçit është një mundësi për të kujtuar ata që, edhe në kushtet më çnjerëzore, zgjodhën të mos hiqnin dorë nga dinjiteti dhe liria. Por njëkohësisht është edhe një mundësi për t'i bërë vetes disa pyetje të rëndësishme:

Si mund ta njohin brezat e rinj këtë histori? Si mund ta kuptojnë atë jo vetëm si një datë në kalendar, por si një përvojë njerëzore?

Pikërisht për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve është ndërtuar platforma **“Mësojmë nga e kaluara: Burime Arsimore të Hapura 1944–1991”**, një projekt i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (2021) sot Ministria e Arsimit.

Kjo platformë është në funksion të Arsimit Prauniversitar mësuesve, nxënësve, prindërve, historianëve dhe studentëve me materiale didaktike me qëllim edukimit historik në fushën e kujtesës. Ajo është një hapësirë edukative që bashkon dokumentet arkivore, dëshmitë, botimet, filmat dokumentarë, ekspozitat dhe aktivitetet edukative për t'ua afruar të rinjve historinë e Shqipërisë gjatë periudhës 1944–1991.

Synimi ynë nuk është vetëm të përcjellim informacion, por t'ju ndihmojmë të kuptoni se historia nuk përbëhet vetëm nga data, ngjarje politike apo vendime shtetërore. Historia përbëhet nga jetët e njerëzve, nga zgjedhjet që ata bëjnë, nga sakrificat, vuajtjet, rezistenca dhe dinjiteti i tyre.

Pjesë e kësaj platforme është edhe **Klubi i Librit “Mësojmë nga e kaluara”**, një projekt edukativ që i drejtohet mësuesve dhe nxënësve, duke vendosur në qendër letërsinë memuaristike si një mjet për të kujtuar historinë.

Pse kemi zgjedhur pikërisht këtë zhanër?

Sepse një dokument arkivor na tregon se çfarë ka ndodhur. Një vendim gjykate na tregon për çfarë është dënuar një person. Një procesverbal na tregon mënyrën se si vepronte aparati shtetëror në këtë rast përmes represionit të ish Sigurimit të Shtetit.

Por një libër kujtimesh na tregon atë që asnjë dokument nuk mund ta shprehë plotësisht: *çfarë ndiente njeriu që e jetoi atë histori.*

Sot kemi privilegjin që autori i këtij libri ndodhet mes nesh. Ai zgjodhi jo vetëm ta shkruante historinë e jetës së tij, por edhe ta rrëfente atë përpara lexuesve. Sot kemi mundësinë ta dëgjojmë se si lindi ideja e këtij libri, pse vendosi ta shkruante, si e përjetoi përndjekjen, si e përballoi

vuajtjen dhe pse mendoj se kjo histori nuk duhej të mbetej vetëm kujtim familjar, por të bëhej pjesë e kujtesës sonë kolektive.

Së bashku me autorin, do të udhëtojmë drejt periudhës më dramatike të jetës së tij. Do të njohim jo vetëm faktet historike, por edhe emocionet, dilemat, dhimbjen dhe forcën me të cilën ai dhe familja e tij përballuan persekutimin.

Kështu, përveç fatit që kemi në duar këtë libër, kemi edhe privilegjin ta kemi atë si një dëshmi të gjallë. Ky është momenti për t'i bërë autorit të gjitha pyetjet që ju kanë lindur gjatë leximit, për të diskutuar me të dhe për ta kuptuar historinë përtej faqeve të librit.

Ky është edhe qëllimi i Klubit të Librit: "Mësojmë kalojmë nga e kaluara" të bashkojë dokumentin arkivor, dëshminë personale dhe kujtesën historike.

Dokumenti na ndihmon të njohim faktet. Dëshmia na ndihmon të kuptojmë përjetimin. Kujtesa na ndihmon të mos harrojmë.

Për këtë arsye, në Klubin e Librit ne zgjedhim vepra autobiografike dhe memuaristike, të shkruara nga ish-të përndjekur politikë ose nga familjarët e tyre, sepse ato i japin zë përvojës njerëzore dhe na ndihmojnë ta lexojmë historinë jo vetëm me sy kritik, por edhe me ndjeshmëri.

Zgjedhëm librin "**Drama e jetës**" të zotit Nestor Topençarov i cili nuk është një shkrimtar por rrëfyes të ngjarjes së jetës së tij ashtu si ka ndodhur, pasi nuk është një roman. Nuk është një histori e trilluar. Është historia e jetuar e një familjeje që u përball me një përndjekje të gjatë politike. Është historia e një familjeje që humbi lirinë, jetoi nën survejim, provoi hetuesinë, burgun, kampet e punës së detyruar dhe izolimin shoqëror. Por mbi të gjitha, është historia e një familjeje që nuk humbi kurrë dinjitetin.

Në faqet e këtij libri, Nestor Topençarovi nuk shkruan vetëm për veten. Ai shkruan për babanë e tij, Kostën, për nënën Marika, për motrën Ivana dhe për plagët që diktatura la në jetën e tyre.

Një pjesë e rëndësishme e këtij rrëfimi zhvillohet pikërisht në kamp-burgun e Spaçit.

Kur lexon përshkrimet e jetës në galeritë e minierës, mbi punën e detyruar, mungesën e ajrit, urinë, dhunën dhe takimet e shkurtra me familjen pas hekurave, kupton se Spaçi nuk ishte thjesht një burg. Ai ishte një sistem i ndërtuar për të thyer fizikisht dhe psikologjikisht njeriun.

Megjithatë, edhe në ato kushte, shumë njerëz arritën të ruanin atë që ishte më e çmuara: dinjitetin. Kjo është arsyeja pse sot, kur kujtojmë Revoltën e Spaçit, nuk kujtojmë vetëm një ngjarje historike. Ne kujtojmë njerëzit. Kujtojmë ata që jetuan atë histori. Kujtojmë ata që guxuan të mos heshtnin.

Përmes librave memuaristikë, historia nuk mbetet më pronë vetëm e atyre që e kanë jetuar. Ajo bëhet përgjegjësi e brezave që vijnë pas.

Prandaj ky libër lexohet jo vetëm si historinë e familjes Topençarov, por si një histori që na ndihmon të kuptojmë sa e çmuar është liria, sa e rëndësishme është drejtësia dhe, mbi të gjitha, sa

i madh është dinjiteti njerëzor, të cilin kjo familje arriti ta ruajë edhe mes torturave, burgut dhe përndjekjes. Ky libër shërben për të ruajtur kujtesën, sepse vetëm një shoqëri që njeh të kaluarën e saj mund të ndërtojë një të ardhme më të drejtë dhe të edukojë qytetarë të përgjegjshëm.